# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-432639**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Katër punonjës të bashkisë i zuri korrenti, njëri humbi jetën, ndalohen drejtori dhe drejtuesi teknik në Tropojë – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/kater-punonjes-te-bashkise-i-zuri-korrenti-njeri-humbi-jeten-ndalohen-drejtori-dhe-drejtuesi-teknik-ne-tropoje/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 9 shtator 2026, 08:59:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 9 shtator 2026, 08:58:14 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 9ed290710214552986d4b5de0d4e8f266737633d7d03d4b23a345bbfe34c8c53 |
| TEKSTI | 7007e8247e0c7a8a4f9df7d912f62caf6c2d0d53735199a27914bccd584d6424 |
| PAMJA | 5c8adc7754e182db146266815951b5bc7ffaf3f57a5ac3477dcd67adb89ed9f0 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 104bc383d6d43bcbf05a82a02fdedbd9e5ced2db36f8d5cac693514add18e458 |
| E MËPARSHMJA | e1c1eaf0dedb731b92e8955145e9a9438dd86dfe926cf1a3058ef37b8a380010 |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/104bc383d6d43bcbf05a82a02fdedbd9e5ced2db36f8d5cac693514add18e458`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**TROPOJË** – Vijojnë hetimet për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes së rëndë të ndodhur një ditë më parë në rrugën e Dobravës, ku një punonjës i Sektorit të Shërbimeve të Bashkisë Tropojë humbi jetën pasi ra në kontakt me rrymën elektrike, ndërsa tre të tjerë u dëmtuan.

Në kuadër të hetimeve, të kryera nën drejtimin e Prokurorisë, Policia ka ndaluar për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” dy persona, drejtorin e Drejtorisë së Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Transportit, N. Gj., 36 vjeç, si dhe drejtuesin teknik të punimeve, G. H., 60 vjeç, të dy banues në Bajram Curri.

Ngjarja ndodhi më 8 shtator, rreth orës 10:00, pranë fshatit Bujan, në rrugën e Dobravës. Sipas hetimeve paraprake, katër punonjës të Bashkisë Tropojë po vendosnin një shtyllë ndriçimi në bazament, kur humbën ekuilibrin dhe shtylla preku telat elektrikë, duke përcjellë rrymën te punonjësit.

Si pasojë e kontaktit me energjinë elektrike, humbi jetën shtetasi Muhamet Sylisufaj, 60 vjeç, ndërsa tre punonjësit e tjerë, Albert Dunisha, 40 vjeç, Ilir Dautaj, 47 vjeç dhe

Afrim Aliaj 21 vjeç, u dërguan për ndihmë mjekësore dhe ndodhen jashtë rrezikut për jetën.

Grupi i posaçëm hetimor vijon punën për dokumentimin e plotë të rrethanave dhe përgjegjësive që lidhen me ngjarjen. Materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë për veprime të mëtejshme.

5 Nafta “kapërcen” 230 lekë për litër, ekspertët: Gabimi që na bën të kemi...

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

#tropoje

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI

**Nis viti i ri shkollor, Skënder Hita mesaz...**

**Xhuljana Zhuleku** · 22 minuta më parë



VENDI

**Alarmi i rremë për bombë në shkollën...**

**Xhuljana Zhuleku** · 28 minuta më parë



LIFESTYLE

**"Nuk doja të largohesha, ika duke...**

**Xhuljana Zhuleku** · 29 minuta më parë

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

● LIVE

**Lajme**
- Politikë
- Bota
- Vendi
- Kronikë
- Lifestyle

**Programe**
- Programe
- Seriale
- Guida TV
- Video
- Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
- Rreth nesh
- Karriera
- Kontakt
- Reklamo me ne
- Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
- Kushtet e përdorimit
- Privatësia
- Cookies
- Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv · Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.